

REPUBLIKA E KOSOVES

MINISTRIA E TREGTISE DHE INDUSTRISE

Projekti për konkurrencën dhe gatishmërinë për eksport

NJOFTIMI PËR PROKURIMIN E PËRGJITHSHEM

SHTETI - Kosovë

EMRI I PROJEKTIT –Projekti për konkurrencë dhe gatishmëri të eksportit

Nr Kredise. 6035XK

Nr. i ID-se se Projektit. 152881

Qeveria e Kosovës - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka marrë financimin në vlerë prej -15.3 milion dollarë, ekuivalente nga Banka Botërore drejt kostos së projektit për Konkurrencën dhe gatishmërisë për eksport dhe synon të aplikojë një pjesë të të ardhurave në pagesa për mallrat, punime, shërbime jo këshilluese dhe shërbimet e konsulencës që do të prokurohen në kuadër të këtij projekti.

Projekti do të përfshij këto komponenta:

Komponenti 1: Përmirësimi i ambientit të biznesit dhe gatishmëria për eksport.

1.1 Mbështetje për njohjen ndërkombëtare të Infrastrukturës Kombëtare të Cilësisë (IKC)

1.2 Mbështetje për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM-të) në përmirësimin e gatishmërisë për të eksportuar

1.3 Reformimi i sistemit të inspektimit të bizneseve

Komponenti 2. Implementimi i projektit dhe koordinimi i mbështetjes

Paketat kryesore që do të jenë procedura në kuadër të këtij projekti pritet të përfshijnë:

Mallra/Pajisje:

- Sistemi i klimatizimit të laboratorit
- Pajisjet për laboratorët e mekanikes
- Pajisjet për laboratorët e elektrikes
- Pajisje për metrologjinë ligjore
- Sistemi E-i inspektimit për të gjitha inspektimet dhe avancimi i menaxhimit të të dhënave të inspektimit si dhe software-i për nxjerrjen e të dhënave
- Sistemi i ndërveprimit të inspektimit dhe avancimi i bazave të të dhënave që ndërlidhen me inspektimit në ministritë dhe agjencitë relevante (shkëmbimi i të dhënave për inspektimet e bazuara në rrezik)
- Deponimi i standardeve dhe akreditimit
- Pajisja dhe modernizimi i inspektimeve.

Shërbimet e konsulencës:

- Mbështetje për prokurimin, pranimin dhe shfrytëzimin e pajisjeve te metrologjisë,
- Kampanja e vetëdijesimit te publikut
- Konsulentët për zhvillim institucional
- Konsulentët për IKC-ne
- Konsulentët për TeR-te dhe specifikat teknike
- Vigjilencë e duhur të të gjitha inspektimeve, IT-se, stafit, hardware, software, bazave të të dhënave për E-inspektimin dhe përgatitjen e draft specifikimeve teknike për sistemin e E-inspektimit

Prokurimi i kontratave të financuara nga Banka Botërore do të bëhen përmes procedurave të përcaktuara në Udhëzimet e Bankës Botërore: Prokurimi sipas huave të IBRD-se dhe Kredive dhe Granteve të IDA-se nga Huamarrësit e Bankës Botërore, janar 2011 i rishikuar në korrik 2014 do të zbatohen për këtë Projekt, dhe është i hapur për të gjithë ofertuesit e kualifikuar siç përcaktohet në udhëzim. Shërbimet e konsulencës do të përzgjidhen në përputhje me Udhëzimet e Bankës Botërore: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve sipas IBRD-se, Kredive dhe Granteve të IDA-se nga Huamarrësit e Bankës Botërore, janar 2011 dhe rishikimi i korrikut 2014. Pas negociatave të projektit, Banka Botërore në ueb-faqen e saj të jashtme do të organizojë botimin e planit të prokurimit fillestar të miratuar dhe të gjitha përditësimet e mëvonshme sapo të mos ketë asnjë kundërshtim.

Njoftimet specifike të prokurimit për kontratat që do të konkurrojnë sipas tenderit ndërkombëtar të ofertave konkurruese të Bankës Botërore (ICB), dhe sapo te jene ne dispozicion do të shpallen në ueb-faqen e OKB-se për Zhvillim të Biznesit, në ueb-faqen e jashtme të Bankës Botërore, gazeta lokale, si dhe njoftime direkte do ti behet kompanive te cilat i janë përgjigjur GPN-së.

Kompanitë dhe individët e denje dhe te interesuar që dëshirojnë të konsiderohen për ofrimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve jo konsulente dhe shërbime konsulente për projektin e përmendur më sipër, ose te interesuarit që kërkojnë informata shtesë, duhet të kontaktojnë Huamarrësin në adresën e mëposhtme:

Personi kontaktues:

Aferdita Selmani

Zyrtare e Prokurimit

Adresa: Rr. "Muharrem Fejza" p.n.Lagjja e Spitalit

10000 Prishtinë/Republika e Kosovës

Numri i telefonit: +38344221852

Email-i: aferdita.a.selmani@rks-gov.net

<http://www.mti-ks.org>